

**RELACION SHOQËRUES**

**KOMPANIA:** ELITE URBAN DEVELOPMENT  
**DREJTUAR:** BALFIN-BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SH.P.K  
**LËNDA:** VENDIM ASAMBLEJE PER ZVOGELIM KAPITALI  
**DATË:** 28.02.2023

**PËRMBLEDHJE E DOKUMENTACIONIT SHOQËRUES**

**QËLLIMI:** Të miratojë zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë me 3,000,000 EUR (tre milion euro), kundërvlehtë në lekë 345,120,000 ALL (treqind e dyzetë e pesëmilion e njëqind e njëzetë mijë lekë). Vlera e kapitalit ishte 1,216,391,824 ALL (Një miliard e dyqind e gjashtëmbëdhjetë milion e treqind e nentëdhjetë e një mijë e tetë qind e njëzetë e katër lekë), do të bëhet 871,271,824 ALL (tetëqind e shtatëdhjetë e një milion e dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e tetëqind e njëzetë e katër lekë).

**PËRMBAJTJA:**


**PROBLEMATIKAT:** JO

**ÇFARË KËRKOHET:** FIRMOSJA E VENDIMIT ASAMBLESE PER ZVOGELIMIN E KAPITALIT

**TË MËTEJSHME :**

**KONCEPTOI / HARTOI:** Personi Përgjegjës ( Departamenti Ligjor)

Rozana KODRARI



Financier (Departamenti Finances)

Mariana Lala



**MIRATOI:** Personi Përgjegjës ( Departamenti Ligjor)

Bers HADO



CEO ELITE URBAN DEVELOPMENT

Dafina KECI



CFO BALFIN

Blerina DAKA





**ELITE URBAN DEVELOPMENT SH.P.K.**  
 Rruga "Tish Daija", Kompleksi Kika 2, Godina 3, Kati 1, Tirane  
**NUIS L62423019U**

**VENDIM**

**I**

**ASAMBLEË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË**

Sot, më datë 28.02.2023 në orën 12.00, në selinë e Shoqërisë Elite Urban Development Sh.p.k me NUIS L62423019U (më tej referuar si "SHOQËRIA"), u mbajt Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me të pranishëm:

- **Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Njesia bashkiake nr.2, Rruga "Papa Gjon Pali II", Ndertesa Nr.12, Kati 11, Zyra nr.1206, Kodi Postar 1010, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: K72223031K, përfaqësuar nga administratori Znj. Edlira Muka, shtetase shqiptare, lindur më 03.02.1983, në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e e letërnjoftimit me nr. 038523830 dhe me nr. personal I35203147R, ( këtu e në vijim referuar si "ortaku i vetëm"),

Znj. Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton Znj.Rozana Kodrari, i cili pranon, të kryejë funksionin e sekretarit.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaroi vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaroi Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit n. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

Meqenëse është i pranishëm Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, (më tej referuar si "**Ortaku**"), zotëruese në masën 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të **Shoqërisë**, mbledhja do të diskutojë rendin e ditës si vijon:

**RENDI I DITËS**

- I. ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË;**
- II. TE NDRYSHME;**

\*\*\*\*\*

**I. ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË**

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, Kryetari parashtron se kapitali aktual i Shoqërisë është 1,216,391,824 LEK (Një miliard e dyqind e gjashtëmbëdhjetë milion e treqind e nentëdhjetë e një mijë e tetëqind e njëzetë e katër lekë) , specifikisht 900,100.00 LEK ( Nëntëqindmijë e njëqind lekë ) në para dhe 1,215,491,724.00 LEK (Njëmiliard e dyqind e pesëmbëdhjetë milion e katërqind e nentëdhjetë e njëmijë e shtatëqind e njëzetekatër lekë) në natyrë. Ortaku për arsye operationale dëshiron të zvogëlojë kapitalin në natyrë me 3,000,000 EUR (tre milion euro) , vlerë të barabartë me 345,120,000 LEK (Treqind e dyzetë e pesëmilion e njëqind e njëzetë mijë lekë), vlerë e cila do të ndryshojë kapitalin në natyrë në vlerën e barabartë 870,371,724.00 LEK (Tetëqind e shtatëdhjetë milion e treqind e shtatëdhjetë e njëmijë e shtatëqind e njëzetë e katër lekë) dhe rrejdhimisht vlerën totale të kapitalit të shoqërisë në vlerën e barabartë me 871,271,824 LEK (Tetëqind e shtatëdhjetë e një milion e dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e tetëqind e njëzetë e katër lekë).

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Asambleja:

**VENDOS:**

- A. Të miratojë zvogëlimin e kapitalit në natyrë të Shoqërisë me një vlerë të barabartë me 345,120,000 LEK (Treqind e dyzetë e pesëmilion e njëqind e njëzetë mijë lekë), rrjellimisht vlera e kapitalit në natyrë nga 1,215,491,724.00 LEK (Njëmiliard e dyqind e pesëmbëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e njëmijë e shtatëqind e njëzet e katër lekë) do të bëhet 870,371,724.00 LEK ( Tetëqind e shtatëdhjetë milion e treqind e shtatëdhjetë e njëmijë e shtatëqind e njëzetë e katër lekë) .
- B. Vlera totale e Kapitalit të Shoqërisë nga 1,216,391,824 LEK (Një miliard e dyqind e gjashtëmbëdhjetë milion e treqind e nëntëdhjetë e një mijë e tetë qind e njëzetë e katër lekë) bëhet 871,271,824 LEK (tetëqind e shtatëdhjetë e një milion e dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e tetëqind e njëzetë e katër lekë).
- C. Autorizohet Administratori i Shoqërisë, për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, nëpërmjet platformës e-albania personalisht ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë për këtë qëllim.

Meqenëse nuk kishte çështje të tjera për t'u shqyrtuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 12.30. Ky Vendim i Shoqërisë, i mbajtur në formën e procesverbalit, nënshkruhet rregullisht në përputhje me parashikimet e nenit 90/3 të Ligjit nr. 9901., datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, nga Sekretari dhe Kryetari i Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve.

\*\*\*\*\*

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË**

**BALFIN - BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SH.P.K**


**SEKRETAR**

  
Znj. Edlira Muka



**BALFIN**  
BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP

**BALFIN sh.p.k.**  
Rruga "Papa Gjon Pali II",  
ABA Business Center, Kati II, Tiranë  
Nipt: K72223031K

  
Znj. Rozana Kodrari



## Kursi zyrtar

Periudha kohore	28.02.2023 - 28.02.2023
Monedha e zgjedhur	Euro (EUR)
<b>Data</b>	<b>Lekë për njësi të monedhës së huaj</b>
28.02.2023	115.04

